

# INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT


Maj 2026

Inflacioni i matur me Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) në muajin Maj 2026 është 3,3 %.

Rritja më e madhe e çmimeve u regjistrua në grupin “Argëtim, sport dhe kulturë” me 7,3 % pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 4,8 %, “Transporti” me 4,2 %, “Sigurime dhe shërbime financiare” me 4,0 %, “Kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme” me 3,9 %, “Restorante dhe shërbime akomodimi” me 3,4 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 3,3 %, “Shërbimi arsimor” me 2,6 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 1,9 %, “Shëndeti” me 1,5 %, “Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera” me 1,3 %, “Veshje dhe këpucë” dhe “Informacioni dhe komunikimi” me 0,6 % secili.


Në Maj 2026, çmimet e konsumit u rritën me 0,2 %, krahasuar me muajin e mëparshëm. Rritja mujore u ndikua kryesisht nga rritja e çmimeve të grupit “Argëtim, sport dhe kulturë” me 1,8 %, pasuar nga grupet “Sigurime dhe shërbime financiare” me 1,0 %, “Shëndeti” me 0,9 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,7 %, “Restorante dhe shërbime akomodimi” me 0,5 %, “Kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme” me 0,3 %, “Informacioni dhe komunikimi” 0,2 %, “Transporti” me 0,1 %. Nga ana tjetër, çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” shënuan një ulje me 0,4 %, pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 0,3 % dhe “Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera” me 0,1 %.

**FIG. 1 NDRYSHIMI VJETOR I IHÇK SIPAS SHTETEVE, MAJ 2026<sup>1</sup>**



<sup>1</sup> INSTAT publikon indekset e pa rumbullakosura, ndërsa EUROSTAT publikon indekset të rumbullakosura me dy shifra dhjetore. Kjo mund të shkaktojë ndryshime midis tyre, për shkak të metodës së ndryshme të rumbullakimit të përdorur nga secili institucion.

FIG. 2 NDIKIMI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR




TAB. 1 NDRYSHIMET NË PËRQINDJE MATUR NGA INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Kodi	Grupet	Peshat	Maj 2026 <sup>2</sup>	05-26/Viti 2025	05-26/05-25	05-26/04-26
	<b>Gjithsej</b>	<b>1000</b>	<b>103,2</b>	<b>3,2</b>	<b>3,3</b>	<b>0,2</b>
01.	Ushqime dhe pije joalkolike	344,6	103,5	3,5	3,3	-0,3
02.	Pije alkolike dhe duhan	51,9	104,3	4,3	4,8	0,7
03.	Veshje dhe këpucë	36,9	100,0	0,0	0,6	-0,4
04.	Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera	57,9	101,3	1,3	1,3	-0,1
05.	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	56,5	101,7	1,7	1,9	0,0
06.	Shëndeti	53,5	101,6	1,6	1,5	0,9
07.	Transporti	82,7	104,4	4,4	4,2	0,1
08.	Informacioni dhe komunikimi	24,5	100,6	0,6	0,6	0,2
09.	Argëtim, sport dhe kulturë	63,9	107,1	7,1	7,3	1,8
10.	Shërbimi arsimor	46,1	101,9	1,9	2,6	0,0
11.	Restorante dhe shërbime akomodimi	144,5	102,8	2,8	3,4	0,5
12.	Sigurime dhe shërbime financiare	6,6	104,1	4,1	4,0	1,0
13.	Kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme	30,5	103,3	3,3	3,9	0,3

<sup>2</sup> 2025=100

**FIG. 3 NDRYSHIMET VJETORE DHE MUJORE TË IHÇK**



**Shënim për përdoruesit:**

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit](#), si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit](#)

# Metodologjia

## Ndryshime metodologjike

Duke filluar nga Shkurt 2026, Indeksi i Çmimeve të Konsumit përlllogaritet sipas klasifikimit ECOICOP 2018. Kalimi në klasifikimin e ri përfshin ristrukturimin e artikujve të shportës, riklasifikimin e disa produkteve. Struktura e ECOICOP ver. 2 përbëhet nga 13 divizione kryesore, të detajuara më tej në grupe, klasa dhe nënklasa. Implementimi i këtij klasifikimi është në përputhje me Rregulloren (BE) 2024/3159, duke siguruar harmonizimin e plotë me praktikat statistikore evropiane dhe ndërkombëtare.

Periudha e referencës së indeksit është ndryshuar nga Dhjetor 2020 = 100 në 2025 = 100.

Gjithashtu, në muajin Janar si çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në të dhënat e Llogarive Kombëtare-Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga **410** produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

## Përkufizime

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve të cilat konsumatori (vendat dhe i huaj) synojnë për konsumin final në territorin e Shqipërisë. IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve të Evropës dhe si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve ndërmjet muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korrente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.

## Krahasimi midis IÇK-së dhe IHÇK-së

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) janë hartuar për të matur ndryshimin e nivelit mesatar të çmimeve të paguara për konsumin e mallrave dhe shërbimeve nga të gjithë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri. IÇK dhe IHÇK përdoren si matës të inflacionit të konsumit.

### Ngjashmëritë midis IÇK dhe IHÇK

- *Qëllimi*

IÇK dhe IHÇK matin ndryshimin në nivelin mesatar të çmimeve të një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh të konsumit.

- *Sistemi i klasifikimit*

IÇK dhe IHÇK përdorin të njëjtin klasifikim të mallrave dhe shërbimeve - Klasifikimi Evropian i Konsumit Individual sipas Qëllimit (ECOICOP Versioni 2)

- *Shpenzimet dhe burimi i të dhënave të shpenzimeve*

Përfshihen vetëm shpenzimet brenda territorit të Shqipërisë. Burimi kryesor i të dhënave për shpenzimet ("peshat") është Anketa e Buxhetit të Familjeve dhe Llogaritë Kombëtare "Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve.

- *Të dhënat e çmimeve*

IÇK dhe IHÇK llogariten bazuar në çmimet e mbledhura në të njëjtat njësi tregtare, përdorin të njëjtën klasifikim të produkteve dhe ndajnë të njëjtën metodologji të hartimit të indeksit.

- *Periudha referuese (bazë) t*

IÇK dhe IHÇK llogariten duke pasur si periudh referuese të indeksit vitin 2025 (2025=100)

- *Metodologjia*

IÇK dhe IHÇK ndjekin metodologjinë e përcaktuar në Rregulloren e Komisionit Evropian (KE), Nr 2016/792, mbi IHÇK, për hartimin dhe grumbullimin e komponentëve të indekseve të çmimeve, e cila është zhvilluar nga Eurostat (Zyra e Statistikave e BE-së) në bashkëpunim me Institutet Statistike Kombëtare të vendeve anëtare të BE-së.

### Dallimet ndërmjet IÇK dhe IHÇK

- *Matës të inflacionit të Çmimeve të Konsumit*

- IÇK është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri
- IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve.

- *Mbulimi i produkteve*

- IÇK përmban 411 artikuj
- IHÇK përmban 410 artikuj

- *Mbulimi dhe burimi i të dhënave për shpenzimet (peshat)*

- Në IÇK mbulohen vetëm shpenzimet e familjeve private shqiptare të kryera brenda dhe jashtë territorit të vendit.
- IHÇK mbulon të gjitha shpenzimet e bëra brenda territorit të vendit nga familjet shqiptare, përfshirë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri.
- *Peshat*
  - Në IÇK peshat janë shprehur në për 100
  - Në IHÇK peshat janë shprehur në për 1000

Kodi	Grupet	Peshat	
		IÇK	IHÇK
	<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>1000</b>
01.	Ushqime dhe pije joalkolike	34,1	344,6
02.	Pije alkolike dhe duhan	5,0	51,9
03.	Veshje dhe këpucë	3,8	36,9
04.	Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera	20,2	57,9
05.	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,0	56,5
06.	Shëndeti	3,2	53,5
07.	Transporti	6,4	82,7
08.	Informacioni dhe komunikimi	3,6	24,5
09.	Argëtim, sport dhe kulturë	2,0	63,9
10.	Shërbimi arsimor	3,0	46,1
11.	Restorante dhe shërbime akomodimi	5,7	144,5
12.	Sigurime dhe shërbime financiare	1,5	6,6
13.	Kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme	4,5	30,5